

# PRIORITETET

*që vazhdojnë të mos arrihen*

*Raport mbi monitorimin e zbatimit të  
Programit Legjislativ për vitin 2023*





Autor: Naim Jakaj

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Ky raport është realizuar me mbështetjen e Rockefeller Brothers Fund (RBF). Qëndrimet e shprehura në këtë raport jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e RBF.

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde

Mbështetur nga:



RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD Rr. Ilaz Agushi  
Prishtinë  
E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Mars, 2024  
Prishtinë, Republika e Kosovës



# LISTA E SHKURTESAVE

|         |   |
|---------|---|
| ZKM     | Zyra e Kryeministrit të Kosovës   |
| RrSMPKP | Rregullorja Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik |
| POKP    | Platforma Online e Konsultimeve Publike   |
| IKD     | Instituti i Kosovës për Drejtësi  |
| PL 2022 | Programi Legjislativ për vitin 2022   |
| KRK     | Kuvendi i Republikës së Kosovës   |
| QRK     | Qeveria e Republikës së Kosovës   |
| QRK     | Qeveria e Republikës së Kosovës   |
| ZKM     | Zyra e Kryeministrit të Kosovës   |
| MPB     | Ministria e Punëve të Brendshme   |
| MFPT    | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve                                      |
| ME      | Ministria e Ekonomisë   |
| ZKM     | Zyra e Kryeministrit të Kosovës   |
| MBPZHR  | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural                            |
| MAPL    | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal                                      |



# Tabela e Përmbajtjes

|   |    |
|---|----|
| 1. Përmbledhje ekzekutive.....  | 6  |
| 2. Efikasiteti në miratimin e koncept dokumenteve.....  | 7  |
| 2.1 Mospërfshirja e koncept dokumenteve nga viti 2022.....  | 8  |
| 2.2 Jo efikasiteti qeveritar në politik bërje.....  | 8  |
| 2.3 (Mos) respektimi i afateve.....   | 8  |
| 2.4 Përfshirja e publikut në politik bërje.....   | 8  |
| 3. Agjenda Legjislative.....  | 10 |
| 3.1 Vazhdimësia e mos stabilitetit të planifikimit .....  | 10 |
| 3.2 Mos zbatimi i Planit të Qeverisë nga Qeveria .....  | 12 |
| 3.2.1 (Mos) Efikasiteti i Ministrive në ligjbërje .....   | 12 |
| 3.3 “Gjysëm planifikimi i ri” .....   | 13 |
| 3.4 Zbrapsja e Qeverisë .....   | 14 |
| 3.5 Konsultimi i publikut në ligjbërje .....  | 14 |
| 4. Miratimi i projektligjeve të proceduara në vitin 2023 të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.....  | 17 |
| 5. Kundërligjshmëria e vendimit të Qeverisë për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve..... | 18 |
| 6. Vonesa në implementimin e obligimeve kushtetuese .....   | 18 |
| 7. Dështimi për ta miratuar Kodin civil .....   | 18 |
| 8. Kundër kushtetutshmëria e qeverisë .....   | 18 |





# 1. Përmbledhje ekzekutive

Kreu i Qeverisë kishte deklaruar se “Karakteri i planifikimit tregon për karakterin e qeverisjes”. Por, jo stabiliteti i programit legjislativ i shprehur në ndryshimet e shpeshta të këtij programi, miratimi i projektligjeve jashtë planifikimit dhe mos zbatimi i plotë i këtij planifikimi flasin për dështim të Qeverisë në fushën e planifikimit qeverisës.

Në Programin e Qeverisë së Kosovës për vitin 2021-2025, Qeveria proklamoi synimin për përgjegjshmërinë institucionale në planifikim dhe në zbatim. Kjo nuk u reflektua në programin legjislativ, i cili u karakterizua nga mos stabiliteti i tij. Brenda vitit 2023, ky plan u ndryshua plot 7 herë. Kështu, Qeveria më tepër pati “planifikim dy mujor” se sa planifikim vjetor legjislativ. Madje, mos stabiliteti i Programit Legjislativ u shfaq menjëherë pas miratimit të tij. Kjo pasi Qeveria e ndryshoj këtë plan vetëm gjashtë ditë pas miratimit të tij.

Dështimi për përmbushjen e Agjendës Legjislative të vitit 2022 u bart në vitin 2023. Kjo pasi IKD gjenë se 44% e agjendës legjislative për vitin 2023 është bartje e agjendës nga viti 2022. Këtu nuk bëjnë pjesë plot 26 Projektligje, nga miratimi i të cilave Qeveria u zbraps në vitin 2023, edhe pse planifikoj që të njëjtat ti miratoj në vitin 2022.

Edhe pse programin legjislativ e miratoi me vonesë, Qeverinë e ka karakterizuar jo-stabiliteti për t’iu përmbajtur programit legjislativ. Ajo në shtatë raste ndryshoi këtë program dhe përkundër këtyre ndryshimeve ajo nuk arriti ta përmbushë në plotni programin legjislativ. Kështu, gjatë vitit 2023, Qeveria më tepër pati Agjendë Legjislative “dy mujore” se sa vjetore.

Përkundër këtyre, Agjenda Legjislative e vitit 2023 nuk u përmbush. Qeveria e Kosovës, deri në fund të vitit 2023 arriti të realizojë 58% të programit legjislativ. Nga 99 projektligjet e planifikuara, Qeveria i miratoi vetëm 57 prej tyre, përderisa 42 të tjera nuk janë miratuar.

Kjo përqindje ka ardhur si rezultat i ndryshimeve të shumta të Programit Legjislativ. Me 8 nëntor kur kaloi më shumë se 83% e vitit, nga Programi Legjislativ u tërhoqën 25 projektligje të pamiratuara, ndërsa 34 projektligjeve i’u ndryshua afati. Kjo lëvizje e qeverisë solli këtë rezultat. Kështu, pa këtë ndryshim, përqindja reale e zbatueshmërisë së planit legjislativ është 46%. Qeveria miratoi edhe 21 projektligje të tjera jashtë planifikimeve në Programin Legjislativ.

Në raport me planifikimet sipas afateve të përcaktuara në programin legjislativ, rezulton se nga 57 projektligjet e miratuara: 48 janë miratuar sipas planifikimit ndërsa 9 projektligje janë miratuar duke mos e respektuar afatin e planifikuar. Kështu, nëse shohim miratimin e Projektligjeve dhe afatit e miratimit të tyre, përballë planifikimit të bërë, atëherë shohim se Qeveria nuk përmbushi plotësisht dhe brenda afateve të parapara në Agjendë Legjislative 84% të Agjendës Legjislative.

Pos Agjendës Legjislative, Qeveria dështoj të përmbushë planin e saj edhe në raport me miratimin e Koncept Dokumenteve. Deri në fund të vitit 2023, Qeveria e Kosovës ka miratuar gjithsej 17 koncept dokumente nga 36 sa kishte planifikuar. Shprehur në përqindje i bie se Qeveria ka përmbushur më pak se 50% të planifikimeve të saja në fushën e miratimit të koncept dokumenteve.

Sa i përket projektligjeve të miratuara sipas Programit Legjislativ për vitin 2023 dhe të proceduara në Kuvendin e Kosovës, ky i fundit ka arritur të miratojë 34 nga 55 apo 62% e projektligjeve që i kanë plotësuar kushtet për t'u proceduar për miratim në lexim të dytë, që i bie 44% e totalit të ligjeve të dërguara në Qeveri dhe vetëm 34% e Ligjeve të planifikuara në Agjendën Legjislative të Qeverisë për vitin 2023. Siç mund të shihet mos efikasiteti i Qeverisë ka vazhduar edhe në Kuvendin e Kosovës. Për më tepër një përqindje e tillë u arritë falë miratimit në lexim të dytë të dhjetë projektligjeve me procedurë të përshpejtuar duke i shmangur afatet e përcaktuara procedurale.

Në këtë raport, IKD ka pasqyruar edhe shkeljet Kushtetuese të Qeverisë dhe Kuvendit në ligjbërje, ku në shumë raste, gjetjet e IKD u konfirmuan edhe nga Gjykata Kushtetuese.

## 2. Efikasiteti në miratimin e koncept dokumenteve

Zhvillimi i politikave të Qeverisë dhe të institucioneve të tjera bëhet mbi bazën e koncept dokumenteve që institucionet i draftojnë dhe miratojnë. Këto dokumente tregojnë një analizë në një fushë të caktuar dhe rekomandojnë masat që duhet ndërmarrë. Më 21 mars 2023, Zyra e Kryeministrit publikoi Listën e Koncept Dokumenteve për vitin 2023, sipas të cilës, deri në fund vitit, synonte të miratonte gjithsejt 33 koncept dokumente.[1] Por, po në të njëjtin muaj, kjo listë ndryshoj, gjersa po e njëjta listë ndryshime pësoj edhe në muajin shtator.[2]



**Treguesi nr. 1** - Ndryshimet në planifikim në Listën e Koncept Dokumenteve

Deri në fund të vitit 2023, Qeveria e Kosovës ka miratuar gjithsej 17 koncept dokumente nga 36 sa kishte planifikuar. Shprehur në përqindje i bie se Qeveria ka përmbushur më pak se 50% të planifikimeve të saja në fushën e miratimit të koncept dokumenteve.



**Treguesi nr. 2** - Efikasiteti i Qeverisë në miratimin e koncept dokumenteve sipas listës së planifikimeve

Niveli prej 47% i miratimit të koncept dokumenteve tregon së pari dështimin në planifikim të mirëfilltë në përgjithësi të Qeverisë së Kosovës dhe në veçanti dështim të zotimit të Kryeministrit të Kosovës në mbledhjen kur miratohet Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 (SKZh 2030) ku ai thotë se transformimi shoqëror mund të bëhet vetëm me planifikim të kujdesshëm dhe të mirëfilltë e po ashtu me zbatim të saj.[3]

Në anën tjetër, IKD ka evidentuar edhe tre koncept dokumente të cilat janë miratuar jashtë planifikimeve vjetore, të cilat janë: koncept-dokumenti në fushën e automjeteve, koncept-dokumenti për faturat e kulturave bujqësore dhe fletëmagazinat dhe koncept-dokumenti për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës. Në këtë mënyrë, përderisa Qeveria nuk ka arritur që të miratojë as 50% të koncept dokumenteve të planifikuara për miratim, ka miratuar koncept dokumente të tjera, të cilat fare nuk kanë qenë të planifikuara. Dështimi për të përmbushur

[1] "Lista e koncept dokumenteve për vitin 2023, Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Mars 2023. (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/Lista-e-Koncept-Dokumenteve-2023..pdf>). (Qasur për herë të fundit më 4 janar 2024).

[2] "Mbledhja e 132-të e Qeverisë së Kosovës, 2023. (Shih linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=M8iJMpXnUv4&t=780s>). (Qasur për herë të fundit më 4 janar 2024).

[3] "Lista e koncept dokumenteve për vitin 2023, Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Shtator 2023. (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/09/Lista-e-Koncept-Dokumenteve-2023-III-.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 4 janar 2024).

Dështimi për të përmbushur planifikimin e saj dhe miratimi i koncept dokumenteve jashtë planifikimit, në thelb, flasin për mungesë të planifikimit. Mos realizimi i punës në bazë të planifikimit të bërë, ia humb kuptimin dhe qëllimin vet planifikimit të bërë nga Qeveria.

## 2.1. (Mos) efikasiteti i ministrive në politik bërje

IKD ka gjetur se me rastin e miratimit të Planit Kombëtar për Zhvillim 2023-2025 dhe me rastin e publikimit të Listës së Koncept Dokumenteve për vitin 2023, Qeveria nuk ka përfshirë 26 koncept dokumente në planifikim për t'u miratuar në vitin 2023 të cilat ishin të planifikuara për miratim në vitin 2022.

Numrin më të madh të koncept dokumenteve të mos përfshira në planifikim e mban Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me nga 4 koncept dokumente. Me 3 koncept dokumente, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, me nga 2 koncept dokumente Zyra e Kryeministrit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Ekonomisë.

Me një koncept dokument që nuk është përfshirë në planifikim për t'u miratuar është Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë.

## 2.1. Jo efikasiteti qeveritar në politik bërje

IKD ka gjetur se MPJD, MM, MASHTI dhe MBPZhR përkundër planifikimit, ato nuk kanë miratuar asnjë koncept dokument. Ndërsa, ZKM, MKRS dhe MKK nuk planifikuan miratimin e asnjë KD. Në anën tjetër, tre ministri sponsorizuan koncept dokumente jashtë planifikimit. Dy prej tyre, këtë e bënë përkundër që nuk sponsorizuan KD që kishin planifikuar. IKD ka gjetur se numrin më të madh të koncept dokumenteve të dërguara dhe miratuar në Qeveri e ka MMPHI me gjashtë KD të miratuara, pasuar nga MD me pesë KD. Mirëpo, asnjëri dikaster qeveritar, nuk përmbushi planikimin e bërë për vitin 2023.

Kështu, IKD gjenë mungesë të efikasitetit të ministrive në fjalë, në kuptim të mos arritjes së përmbushjes së planifikimit të bërë. Në raport me totalin e planifikuar, Qeveria nuk arriti që të përmbushë as gjysmën e këtij planifikimi, duke miratuar vetëm 47% të KD të planifikuara. Krahasimisht me vitin e kaluar, ka një progres, nga 29.6%<sup>[4]</sup> në 47%. Mirëpo, as gjatë vitit 2023, Qeveria nuk arriti të përmbushë as gjysmën e planifikimit që bëri.

[4] Jakaj N. "Planifikimi (Jo) Adekuat i Qeverisë (Raport mbi Monitorimin e Zbatimit të Programit Legjislativ për vitin 2022)" fq. 16. Prishtinë, Shkurt 2023. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/02/Planifikimi-Jo-adekuat-i-Qeverise-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 5 janar 2024)

| Nr. | Sponsorizuesi  | Të planifikuara për vitin 2023 | Të miratuara në Qeveri | % e koncept dokumenteve të miratuara |
|-----|--|--------------------------------|------------------------|--------------------------------------|
| 1   | Ministria e Drejtësisë   | 6                              | 5                      | 83%                                  |
| 2   | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | 8                              | 6                      | 75%                                  |
| 3   | Ministria e Ekonomisë  | 2                              | 1                      | 50%                                  |
| 4   | Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë               | 6                              | 2                      | 33,33 %                              |
| 5   | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve                     | 5                              | 2                      | 50%                                  |
| 6   | Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike        | 1                              | 1                      | 100%                                 |
| 7   | Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës                      | 1                              | 0                      | 0%                                   |
| 8   | Ministria e Mbrojtjes  | 1                              | 0                      | 0%                                   |
| 9   | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit      | 1                              | 0                      | 0%                                   |
| 10  | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural           | 5                              | 0                      | 0%                                   |
| 11  | Ministria e Shëndetësisë   | 0                              | 0                      | 0%                                   |
| 12  | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | 0                              | 0                      | 0%                                   |
| 13  | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit                         | 0                              | 0                      | 0%                                   |
| 14  | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal                     | 0                              | 0                      | 0%                                   |
| 15  | Ministria për Komunitete dhe Kthim                               | 0                              | 0                      | 0%                                   |
| 16  | Ministria e Zhvillimit Rajonal                                   | 0                              | 0                      | 0%                                   |
|     |  | 36                             | 17                     | 47%                                  |

**Tabela nr. 1** - Numri i koncept dokumenteve të miratuara sipas ministrive.

## 2.3 (Mos) respektimi i afateve

Lista e koncept dokumenteve përcaktoj edhe afatet se kur Qeveria do duhej të miratonte KD e listuara. Në raport me këtë planifikim, IKD gjenë se nga 17 koncept dokumentet e miratuara, afati u respektua në vetëm 5 prej tyre:

|   |    |
|---|----|
| Koncept dokumente të miratuara sipas Listës së Koncept Dokumenteve (2023) | 17 |
| Të miratuara sipas planifikimeve  | 5  |
| Të miratuara jashtë afatit të dhënë në LKD 2023                           | 12 |

**Tabela nr. 2** - Numri i projektligjeve të miratuara sipas planifikimeve dhe projektligjeve të miratuara jashtë afatit të dhënë në LKD 2023.

Kështu, përpos dështimit të Qeverisë që të miratojë të paktën gjysmën e KD të planifikuara, Qeveria dështoj të respektoj edhe afatin e planifikuar, në ato raste kur miratoi KD. Ky mos respektim është i shprehur shkallë prej 70.5% të rasteve.


Kështu, nëse shohim rastet kur Qeveria ka miratuar koncept dokumentet sipas LKD dhe të njëjtat i ka miratuar brenda afatit të planifikuar, atëherë i bie se planifikimi sipas LKD u zbatua në vetëm 13.8% të rasteve. Mos zbatimi i këtij planifikimi në mbi 86% të tij flet për dështim të theksuar të Qeverisë në përmbushjen e planifikimit të bërë nga vet Qeveria.

## 2.4 Përfshirja e publikut në politik bërje

Rregullorja Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik e miratuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2016 ka përcaktuar parimet e përgjithshme si dhe obligimet e institucioneve qendrore dhe lokale që me rastin e miratimit të dokumenteve të rëndësishme t'i nënshtrohen procesit të konsultimit. Institucionet e kanë për obligim që këto dokumente t'i vendosin në platformën online të

konsultimeve publike për të paktën 15 ditë pune ose për dokumente me më rëndësi deri në 60 ditë.[5]

Sipas të dhënave në këtë platformë, rezulton se nga 20 koncept dokumentet e miratuara në Qeveri, në platformë për konsultime publike janë publikuar 19 projekt koncept dokumente[6]. Shprehur në përqindje i bie se Qeveria e ka zbatuar këtë obligim në 95% të rasteve. Ndërsa, afati minimal i konsultimeve publike është pesëmbëdhjetë ditë.



**Treguesi nr. 3** - Publikimi i projekt koncept dokumenteve për konsultim publik

Përkundër mos publikimit të një KD, statistikën flasin për ngritje të respektimit të këtyre standardeve. Në raportin e kaluar, IKD kishte gjetur se përqindja e KD që Qeveria i kishte publikuar për konsultime publike ishte 73.9%, derisa këtë vit, kjo statistikë ka një ngritje prej 21.1%. Kështu, me një përjashtim, Qeveria në secilin rast zbatoi standardet minimale në procesin e konsultimeve publike.


[5] Neni 2, 4 dhe 5 Rregullorja Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, Gazeta Zyrtare e Kosovës, 2016. (Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036>). (Qasur për herë fundit më 5 janar 2024).

[6] Shënim: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në kundërshtim me Rregulloren për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik nuk ka vendosur për konsultime publike një koncept dokument, atë për Rregullimin e Fushës së Punësimit.

### 3. Agjenda Legjislative

Qeveria e Kosovës, sikurse në vitin paraprak [2022] ka vazhduar me praktikën e njejtë të vonesave në miratimin e Programit Legjislativ. Një dokument të tillë do të duhej të miratohej në fund të muajit dhjetor të vitit paraprak. Me 25 janar 2023, në mbledhjen e 121-të Qeveria miratoi Programin Legjislativ Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2023, përmes të cilit planifikonte të miratoj 100 projektligje.[7] Por, për shkak të ndryshimit dhe plotësimit të programit legjislativ deri në fund të vitit 2023, ky program arriti deri në 120 ligje për t'u miratuar.

Nga totali i 120 projektligjeve të planifikuara, del se 63 projektligje janë të reja, 29 projektligje janë marrëveshje ndërkombëtare dhe 28 projektligje janë ndryshim-plotësime.



**Treguesi nr. 4 - Lloji i projektligjeve në Programin Legjislativ për vitin 2023**

#### 3.1. Vazhdimësia e mos stabilitetit të planifikimit

Përkundër faktit që programi legjislativ u miratua me vonesë, ky program u ndryshua dhe plotësua gjatë tërë vitit plot shtatë herë.[8] (shih tabelën 3).

Në punën e saj, Qeveria duhet të sigurohet që të miratojë dokumente që tregojnë planifikimin e saj vjetor dhe që këtë planifikim ta përcjellë dhe ta zbatojë sipas afateve të përcaktuara. Përmes këtyre dokumenteve vjetore planifikuese Qeveria duhet të sigurohet që synimet dhe qëllimet e saj t'i realizojë përmes përmbushjes së planit brenda afatet të caktuar.

Në linjë me këtë synim, IKD gjenë dy dështime të Qeverisë: Planifikim jo stabil dhe mos realizim të tij.

Në Programin e Qeverisë së Kosovës për vitin 2021-2025, Qeveria proklamoi synimin për përgjegjshmërinë institucionale në planifikim dhe në zbatim.[9] Kjo nuk u reflektua në programin legjislativ, i cili u karakterizua nga mos stabiliteti i tij. Brenda vitit 2023, ky plan u ndryshua plot 7 herë.

[7] "Programi Legjislativ për vitin 2023", Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Janar 2023. (Shih linkun <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/Programi-Legjislativ-per-vitin-2023-25.1.2023.pdf>). (Qasur për herë fundit më 5 janar 2024).

[8] "Vendimet e Qeverisë së Kosovës për vitin 2023", Gazeta Zyrtare e Kosovës, 2023, (Shih vegëzat: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/Vendimet-e-mbledhjes-se-122-te-te-Qeverise-1.pdf>, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/Vendim-i-mbledhjes-se-133-te-i-Qeverise-1.pdf>, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Vendimet-e-mbledhjes-se-138-te-Qeverise-1-.pdf>, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/05/Vendimet-e-mbledhjes-se-143-te-Qeverise.pdf>, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/08/Vendimet-e-mbledhjes-se-154-te-Qeverise.pdf>, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/10/Vendimet-e-mbledhjes-se-165-te-te-Qeverise-compressed-1.pdf>, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/11/Vendimet-nga-mbledhja-e-172-te-e-Qeverise.pdf>). (Qasur për herë fundit më 5 janar 2024).

[9] "Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025", Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Mars 2021. (Shih linkun <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>). (Qasur për herë fundit më 5 janar 2024).

Kështu, Qeveria më tepër pati “planifikim dy mujor” se sa planifikim vjetor legjislativ. Madje, mos stabiliteti i Programit Legjislativ u shfaq menjëherë pas miratimit të tij. Kjo pasi Qeveria e ndryshoj këtë plan vetëm gjashtë ditë pas miratimit të tij.

| Nr. | Data e ndryshimit të Programit Legjislativ për vitin 2023 | Numri i vendimit dhe i mbledhjes së Qeverisë | Ndryshimi  |
|-----|---|--|--|
| 1   | 31.01.2023  | 01-122                                       | U shtuan dy (2) projektligje.  |
| 2   | 09.03.2023  | 01-133                                       | U shtua një (1) projektligj.   |
| 3   | 12.04.2023  | 02/138                                       | U shtuan 12 projektligje.  |
| 4   | 24.05.2023  | 15/143                                       | U shtuan tre (3) projektligje.   |
| 5   | 09.08.2023  | 01/154                                       | U shtuan katër (4) projektligje, i'u ndryshua afati i miratimit 13 projektligjeve.   |
| 6   | 12.10.2023  | 01/165                                       | U tërhoqën katër (4) projektligje, i'u ndryshua afati i miratimit një projektligji.  |
| 7   | 08.11.2023  | 02/172                                       | U shtuan dy (2) projektligje, i'u ndryshua afati i miratimit 20 projektligjeve, dhe barten për miratim në vitin 2024, 21 projektligje. |

**Tabela nr. 3 - Vendimet e Qeverisë për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ**

Përtej gjitha këtyre ndryshimeve, Qeveria, përkundër mos zbatimit të plotë të Programit Legjislativ, miratoi Projektligje jashtë planifikimeve të saja. 26.9% e Projektligjeve të miratuara nga Qeveria janë jashtë planifikimeve në Programin Legjislativ. Thënë më ndryshe, çdo i katërti projektligj i miratuar është i pa planifikuar:



**Treguesi nr. 5 - Treguesi i ndryshimit dhe plotësimit të Programit Legjislativ gjatë vitit 2023**

Në anën tjetër, siç do të shihet edhe në kapitullin vijues, Qeveria përkundër ndryshimeve të vazhdueshme, nuk arriti të implementoj në tërësi Programin Legjislativ që vet e miratoj. Vet kreu i Qeverisë kishte deklaruar se “Karakter i planifikimit tregon për karakterin e qeverisjes”[10]. Por, jo stabiliteti i programit legjislativ i shprehur në ndryshimet e shpeshta të këtij programi, miratimi i projektligjeve jashtë planifikimit dhe mos zbatimi i plotë i këtij planifikimi flasin për dështim të Qeverisë në fushën e planifikimit qeverisës.

[10] “Kurti: Transformimi shoqëror nuk arrihet pa planifikim të kujdesshëm”, Koha.net, Tetor 2021. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/294128/kurti-transformimi-shoqeror-nuk-arrihet-pa-planifikim-te-kujdesshem/>). (Qasur për herë fundit më 5 janar 2024).



## 3.2. Mos zbatimi i Planit të Qeverisë nga Qeveria

Qeveria e Kosovës, deri në fund të vitit 2023 arriti të realizojë 58% të programit legjislativ. Nga 99 projektligjet e planifikuara, Qeveria i miratoi vetëm 57 prej tyre, përderisa 42 të tjera nuk janë miratuar.

99

Projektligje të planifikuara

57

Projektligje të miratuara

58%

Përqindja e realizimit

**Treguesi nr. 6** - Treguesi i ndryshimit dhe plotësimit të Programit Legjislativ gjatë vitit 2023

Por, kjo përqindje ka ardhur si rezultat i ndryshimeve të shumta të Programit Legjislativ. Me 8 nëntor kur kaloi më shumë se 83% e vitit, nga Programi Legjislativ u tërhoqën 25 projektligje të pamiratuara, ndërsa 34 projektligjeve i'u ndryshua afati.<sup>[11]</sup> Kjo lëvizje e qeverisë solli këtë rezultat. Kështu, pa këtë ndryshim, përqindja reale e zbatueshmërisë së planit legjislativ është 46%.

Në raport me planifikimet sipas afateve të përcaktuara në programin legjislativ, rezulton se nga 57 projektligjet e miratuara: 48 janë miratuar sipas planifikimit ndërsa 9 projektligje janë miratuar duke mos e respektuar afatin e planifikuar.

57

Projektligje të miratuara (PL 2023)

48

Projektligje të miratuara sipas planifikimeve

9

Projektligje të miratuara jashtë afatit të dhënë në PL 2023

**Treguesi nr. 7** - Numri i projektligjeve të miratuara sipas planifikimeve dhe projektligjeve të miratuara jashtë afatit të dhënë në PL 2023

Në këtë mënyrë, përveç mospërbushjes së planit legjislativ, në 48% të pjesëve ku është përmbushur programi legjislativ, ky plan nuk është përmbushur sipas afateve të paracaktuara. Kështu, nëse shohim miratimin e Projektligjeve dhe afatit e miratimit të tyre, përballë planifikimit të bërë, atëherë shohim se Qeveria nuk përmbushi plotësisht dhe brenda afateve të parapara në Agjendë Legjislative 84% të Agjendës Legjislative.

### 3.2.1 (Mos) Efikasiteti i Ministrive në ligjbërje

Sa i përket nivelit të zbatimit të Programit Legjislativ, në raport me planifikimet nga secila ministri veç e veç rezulton se përqindjen më të lartë të përmbushjes së planifikimit të bërë e mban MM dhe MAPL me 100% të realizimit, e pasuar me MD me 80% të realizimit të programit legjislativ. Ministrinë më jo efektive në kuptim të përqindjes së zbatimit të programit legjislativ janë MASHTI dhe MPJD me asnjë projektligj të miratuar sipas planifikimeve.

[11] "Mbledhja e 172-të e Qeverisë së Kosovës, Zyra e Kryeministrit, 8 nëntor 2023. (Shih linkun <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/11/Vendimet-nga-mbledhja-e-172-te-e-Qeverise.pdf>). (Qasur për herë fundit më 5 janar 2024).

| Nr. | Sponsorizuesi  | Projektligje të planifikuara | Të miratuara në Qeveri | Projektligje të miratuara jashtë planifikimeve | % e projektligjeve të miratuara në Qeveri |
|-----|--|------------------------------|------------------------|--|---|
| 1   | Ministria e Mbrojtjes  | 2                            | 2                      | 0  | 100%                                      |
| 2   | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal                     | 2                            | 2                      | 0  | 100%                                      |
| 3   | Ministria e Drejtësisë   | 5                            | 4                      | 5  | 80.00%                                    |
| 4   | Zyra e Kryeministrit   | 8                            | 6                      | 2  | 75%                                       |
| 5   | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural           | 4                            | 3                      | 1  | 75%                                       |
| 6   | Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike        | 16                           | 10                     | 0  | 63%                                       |
| 7   | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve                     | 15                           | 9                      | 9  | 60%                                       |
| 8   | Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë               | 12                           | 7                      | 0  | 58%                                       |
| 9   | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | 13                           | 7                      | 0  | 54%                                       |
| 10  | Ministria e Shëndetësisë   | 4                            | 2                      | 0  | 50%                                       |
| 11  | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit                         | 6                            | 3                      | 0  | 50%                                       |
| 12  | Ministria e Ekonomisë  | 7                            | 2                      | 0  | 29%                                       |
| 13  | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit      | 2                            | 0                      | 3  | 0%  |
| 14  | Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës                      | 3                            | 0                      | 1  | 0%  |
|     |  | 99                           | 57                     | 21   | 58%                                       |

**Tabela nr. 4 - Numri i projektligjeve të miratuara sipas ministrive**

### 3.3. “Gjysëm planifikimi i ri”

Në Raportin për zbatimin e programit legjislativ për vitin 2022 me titull “Planifikimi (Jo) adekuat i Qeverisë” është treguar se si programi legjislativ për atë vit ka qenë bartje e agjendës legjislative në masën prej 45% nga viti paraprak. Në bazë të analizës për programin legjislativ për vitin 2023, IKD gjenë se 44% e agjendës legjislative për vitin 2023 është bartje e agjendës nga viti 2022.



**Numri i projektligjeve të reja dhe atyre të bartura nga viti 2021**

**Treguesi nr. 8 - Numri i projektligjeve të reja dhe atyre të bartura nga viti 2022**

Në këtë mënyrë, IKD gjenë se Qeveria dështimin për përmbushjen e Agjendës së saj Legjislative e ka bartur vit pas viti. Në këtë situatë, duke u bartur nga rreth gjysma e Projektligjeve, Agjenda Legjislative e Qeverisë më shumë ngjason si gjysëm planifikim, për shkak se gjysma tjetër e saj, është vazhdimësi e dështimit një vit më parë të përmbushjes së Agjendës Legjislative.

## 3.4 Zbrapsja e Qeverisë


IKD gjen se Qeveria e Kosovës nuk përfshiu 26 projektligje, të cilat kanë qenë në plan programin legjislativ për vitin 2022, dhe të cilat nuk janë miratuar gjatë atij viti.

Në mesin e këtyre projektligjeve janë ai për Këshillin Ekonomiko-Social, projektligji për Inspektoratin e Punës, projektligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare, projektligji për Vlerësimin, Njohjen e Statusit, Përfitimet dhe Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuar. Më tutje, Qeveria nuk përfshiu miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin për Policinë, në Ligjin për Institutin e Kosovës për Administratë Publike, në Ligjin për Ripanim, në Ligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore, në Ligjin për Organizimin e Institutit Bujqësor të Kosovës, Projektligjin për Zonat Ekonomike, Projektligjin për Nxitjen dhe Mbrojtjen e Investimeve, Projektligji për Inovacion dhe Ndërmarrësi etj.

26 Projektligje janë masë e konsiderueshme e pragramit legjislativ. Ky numër paraqet 15 të programit legjislativ të vitit 2022 apo 22% të PL për vitin 2023. Kështu, kjo tëheqje e Qeverisë për këtë pjesë të programit legjislativ paraqet zbrasje të konsideruar të Qeverisë nga synimet e saja. Kjo zbrasje paraqet ose dëshmi të planifikimit jo adekuat në fillim ose dështim të Qeverisë për të shtyrë politikat e saja të planifikuara. Por, për gjithë këtë, Qeveria nuk dha asnjë sqarim.

## 3.6. Konsultimi i publikut në ligjbërje

Është përgjegjësi e Qeverisë që projektligjet para miratimit të tyre t'i vendosë në platformën e konsultimit publik për të paktën 15 ditë pune.[12] Përfundim këtu bëjnë marrëveshjet ndërkombëtare të cilat nuk i nënshtrohen konsultimit me publikun. Nga 54 projektligje për të cilat qeveria duhej të zhvillonte konsultime publike, në 43 prej tyre qeveria plotësoi këtë obligim, ndërsa 11 prej tyre jo. Shpresur në përqindje, qeveria përfshiu publikun, sipas obligimit që ka, në 80% të rasteve të miratimit të projektligjeve.



**Treguesi nr. 9** - Numri i projektligjeve të miratuara dhe i atyre në Platformën e Konsultimeve Publike

Kështu, ka një shpërfillje të theksuar të zbatimit të obligimeve lidhur me përfshirjen e publikut në procesin legjislativ. Kjo shpërfilljekonsiston në mos zbatim të standardeve minimale të konsultimeve publike në 20% të rasteve. Pra, Qeveria miratoi pa përfshirjen e publikut pothuajse çdo të pestin projektligj. Kjo praktikë është shkelje e Rregullores së Qeverisë për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik dhe është shkelje e standardeve të qeverisjes së mirë.

Sipas dikastereve, IKD gjenë se ZKM, MPB dhe MINT nuk kanë vendosur nga një projektligj në konsultime publike, tri projektligje nuk janë vendosur nga MD dhe pesë projektligje nuk janë vendosur nga MFPT.

[12] "Neni 5, nënparagrafi 1.6, Rregullorja për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik", 2016, Gazeta Zyrtare e Kosovës. (Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036>). (Qasur për herë të fundit me 7 janar 2024).

## 4. Miratimi i projektligjeve të proceduara në vitin 2023 të miratuara nga Kuvendi i Kosovës

Sa i përket projektligjeve të miratuara sipas Programit Legjislativ për vitin 2023 dhe të proceduara në Kuvendin e Kosovës, ky i fundit ka arritur të miratojë 34 nga 55 apo 62% e projektligjeve që i kanë plotësuar kushtet për t'u proceduar për miratim në lexim të dytë, që i bie 44% e totalit të ligjeve të dërguara në Qeveri dhe vetëm 34% e Ligjeve të planifikuara në Agjendën Legjislative të Qeverisë për vitin 2023. Siç mund të shihet mos efikasiteti i Qeverisë ka vazhduar edhe në Kuvendin e Kosovës.

Për më tepër një përqindje e tillë u arritë falë miratimit në lexim të dytë të dhjetë projektligjeve me procedurë të përsheptuar duke i shmangur afatet e përcaktuara procedurale.[13]



*Treguesi nr. 10 - Numri i projektligjeve të proceduara në Kuvend (PL 2022) dhe të miratuara në Kuvendin e Kosovës.*

[13] "Transkript i Seancës së Jashtëzakonshme të Kuvendit", 2023, Kuvendi i Kosovës. (Shih linkun [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023\\_12\\_14\\_ts\\_Seanca,ora18.00\\_2LuWLzfFbg.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_12_14_ts_Seanca,ora18.00_2LuWLzfFbg.pdf)). (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2024).

## 5. Kundërligjshmëria e vendimit të Qeverisë për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Me 22 nëntor 2022, Qeveria e Kosovës mori vendim për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ajo shfuqizoi vendimin e Qeverisë së Kosovës të nxjerrë me 20 dhjetor 2017 ku në atë kohë në mënyrë të kundërligjshme dhe në konflikt të interesit Qeveria kishte rritur pagat e kabinetit qeveritar, rritje e cila do të refleктоhej më pas tek pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Shoqëria civile kishte reaguar për vendimin e marrë atë kohë nga Qeveria e udhëhequr nga Kryeministri Ramush Haradinaj me arsyetimin se një rritje e tillë duhet të bëhej vetëm përmes ligjit dhe jo vendimeve ad-hoc.[14] Një gjë e tillë nuk ishte marrë parasysh. Për më tepër, vendimi i Qeverisë Haradinaj ishte konfirmuar edhe përmes Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin K012/18.[15]

Përkundër këtij konfirmimi Qeveria e udhëhequr nga Kryeministri Albin Kurti në nëntor të vitit 2022 mori vendim për uljen e pagave dhe gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo përkundër faktit se në momentin kur Qeveria ia kishte ulur pagat vetes dhe jo gjyqtarëve dhe prokurorëve, ishte thirrur në nenet që gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk mund tu ulet paga gjatë mandatit të tyre.[16]

Nën arsyetimin se pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve në sistemin e drejtësisë nuk mund të ulen gjatë mandatit të tyre, pasi që janë të drejta të fituara dhe të garantuara me ligj dhe si të tilla nuk mund të cenohen, Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë, me 23 tetor 2023 kishte anuluar si të kundërligjshëm vendimin e Qeverisë së Kosovës për uljen e pagave të prokurorëve dhe gjyqtarëve. Padia ishte ushtruar nga Shoqata e Prokurorëve të Kosovës. Të njejtin vendim e konfirmoi Gjykata e Apelit pasi që vendimi u ankimua nga Qeveria e Kosovës.[17]

## 6. Vonesa në implementimin e obligimeve kushtetuese

Gjykata Kushtetuese shfuqizoi paragrafin 2 të nenit 8 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale. Sipas Gjykatës, ky paragraf në mënyrë diskriminuese përjashtonte mijëra qytetarë nga pensioni kontributdhënës ngase nuk e përmbushnin kriterin e përvojës prej 15 viteve pune para janarit të viti 1999. Në mungesë të përvojës prej 15 viteve, ata gëzonin vetëm pensionin e moshës. GjK, shpalli këtë dispozitë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës si dhe urdhëroi Kuvendin dhe Qeverinë, që jo më larg se data 15 korrik 2023, të ndërmarrin veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji.

Qeveria e Kosovës ishte në dijeni Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin, sepse në radhë të parë njoftimi për këtë aktgjykim ishte bërë publik me 30 dhjetor 2022, përderisa aktgjykimi ishte publikuar me 16 janar 2023. Përkundër faktit që Qeveria ishte në dijeni për kërkesat e këtij aktgjykimi, ajo nuk i përfshiu në programin legjislativ ndryshimet në ligjin bazik, atë të skemave pensionale të financuara nga shteti, ashtu siç kërkohet nga Gjykata Kushtetuese.

[14] "Loja e Kundërligjshme e Kryeministrit me Pagat", 2017, IKD. (Shih linkun <https://kli-ks.org/loja-e-kunderligjshme-e-kryeministrit-me-pagat/>). (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2024)

[15] "Aktgjykim në rastin K012/18", 2018, Gjykata Kushtetuese. (Shih linkun [https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2018/06/ko\\_12\\_18\\_agj\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2018/06/ko_12_18_agj_shq.pdf)). (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2024)

[16] "Vendimi nr. 01/02 i Qeverisë së Kosovës" 12 shkurt 2020, Zyra e Kryeministrit, 2020. (Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71845>). (Qasur për herë të fundit me 15 janar 2024)

[17] "Apeli vërteton vendimin e Themelores për anulimin e vendimit të Qeverisë për uljen e pagave të prokurorëve dhe gjyqtarëve", 2023, Betimi për Drejtësi. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-vendimin-e-themelores-per-anulimin-e-vendimit-te-qeverise-per-uljen-e-pagave-te-prokuroreve-dhe-gjyqtareve/>). (Qasur për herë të fundit me 15 janar 2024)

Vetëm në ndryshimin dhe plotësimin e pestë të programit legjislativ për vitin 2023, Qeveria vendosi që miratimi i projektligjit për skemat pensionale të hyjë në agjendën legjislative dhe atë që këto ndryshime të miratoheshin deri me 30 korrik 2023, me 15 ditë vonesë.

Afati i vendosur ishte në kundërshtim me kërkesat e GJK-së. Kërkesat e kësaj të fundit kishin të bënin me atë që një ligj i tillë duhej të hynte në fuqi dhe të zbatohet prej datës 15 korrik dhe jo që miratimi i projektligjit të ndodhej në qeveri dhe atë me vonesë prej 15 ditëve vonesë.

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e saj të 149-të, miratoi Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përderisa Kuvendi këtë projektligj e miratoi në lexim të dytë me 27 korrik 2023 i cili hyri në fuqi me 16 gusht 2023. Kjo në kundërshtim me afatet e vendosura nga Gjykata Kushtetuese.

## 7. Dështimi për ta miratuar Kodin civil

IKD, ka gjetur se përkundër premtimit të Qeverisë së Kosovës, respektivisht Ministres së Drejtësisë se Projekt Kodi Civil do të sjellet për miratim së shpejti në Qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës[18], i njëjti projekt kod nuk u miratua sipas planifikimeve (30 qershor 2023).[19] Edhe pse nuk e miratoi sipas planifikimeve, Qeveria në mbledhjen e saj të 172-të, ndryshoi programin legjislativ për vitin 2023 duke i bartur për vitin tjetër 21 projektligje të planifikuara për këtë vit ku në mesin e tyre është edhe Kodi Civil. Në fjalën e tij, kryeministri i Kosovës Albin Kurti nuk përmendi ndonjë arsyetim të qartë se cilat janë shkaqet e shtyrjes së miratimit të Kodit Civil. Ai tha se për shkak të planifikimit më të mirë duhet shqyrtuar dhe miratuar vitin e ardhshëm 21 projektligjet e shtyra.”

Në këtë mënyrë, Qeveria dështoi të ndërmarrë hapa në drejtim të miratimit të njërit ndër ligjeve më bazike të drejtësisë civile. Një dështim të tillë e përmend edhe Raporti i Progresit për vitin 2023 ku theksohet se me miratimin e këtij kodi do të përforcohet mbrojtja e të drejtave civile dhe themelore të grave.[20]

## 8. Kundër kushtetutshmëria e qeverisë

Gjatë vitit 2022, IKD në raportet hulumtuese dhe analitike ka gjetur se Qeveria e Republikës së Kosovës në disa nga projektligjet e miratuara nuk kanë respektuar dispozitat kushtetuese. Projektligjet e njejtja janë miratuar nga ana e Kuvendit të Kosovës duke mos i marrë parasysh në mënyrë adekuate vërejtjet dhe komentet e organizatave të shoqërisë civile, të Bashkimit Evropian dhe të ambasadave të ndryshme në Kosovë. Të njejtat ligje i'u nënshtruan kontrollit kushtetues, ligje të cilat në masë të madhe u dërguan nga grupet parlamentare opozitare dhe një ligj nga Avokati i Popullit.

Kështu, Gjykata Kushtetuese rrëzoi në tërësi Ligjin Nr.08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ligj i cili përbën reformën më të rëndësishme në drejtësi të proklamuar nga Qeveria e Kosovës.[21]

[18] "Haxhiu: Projektkodin Civil shumë shpejt do ta procedojmë në Kuvend, kësaj radhe do të kalojë", 2022, Betimipër Drejtësi. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/haxhiu-projektkodin-civil-shume-shpejt-do-ta-procedojme-ne-kuvend-kesaj-radhe-do-te-kaloje/>). (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2024).

[19] "Programi Legjislativ për vitin 2023", 2023, Zyra e Kryeministrit të Kosovës. (Shih linkun <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/08/Programi-Legjislativ-per-vitin-2023.pdf>). (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2024).

[20] "Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023", fq 29 dhe 29. (Shih linkun: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SĚD\\_2023\\_692%20Kosovo%20report\\_0.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SĚD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf)). (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2024).

[21] Aktgjykim në rastin nr. KO79/23, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, 23 janar 2024. (Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85575>), (Qasur për herë të fundit me 8 janar 2024).

Gjykata Kushtetuese gjeti Ligji për Zyrtarët Publikë në disa nene përmbante shkelje kushtetuese, nene të cila ajo i shfuqizoi. GJK obligoi Kuvendin që në afatin prej 6 muaj nga hyrja në fuqi e aktgjykimit të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit në raport me nenet e shfuqizuara nga kjo gjykatë.

GJK po ashtu gjeti shkelje kushtetuese në Ligjin për Pagat në Sektorin Publik[22], duke konfirmuar shumicën dërrmuese të komenteve të IKD-së[23], të cilat nuk ishin marrë parasysh nga Qeveria.[24] Sikurse në rastin me Ligjin për Zyrtarët Publik, ajo shpalli disa nene në kundërshtim me Kushtetutën, të cilat ajo i shfuqizoi dhe kërkoi nga Kuvendi i Kosovës që për disa nene të tjera brenda afatit prej gjashtë muajve t'i ndryshojë. Në të njejtën kohë, GJK vendosi që përmbajtja tjetër e ligjit të mbetet në fuqi.

Në anën tjetër, përkundër gjetjeve të IKD-së në lidhje me Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, respektivisht për politizimin anitkushtetues të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas[25], asnjë nga palët e autorizuara në këtë rast deputetët dhe për më tepër as pas kërkesës së IKD-së në drejtim të Avokatit të Popullit, ku i fundit nuk dërgoi në GJK këtë ligj për t'u vlerësuar kushtetutshmëria. Madje, Avokati i Popullit asnjëherë nuk kthej përgjigje në këtë kërkesë, përkundër se nga ky institucion kishin thënë se janë duke e shqyrtuar kërkesën.

Në anën tjetër, gjetjet e IKD-së në lidhje me Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës[26], nuk u përfillën nga ana e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Ligji tanimë ndodhet në procedurë të shqyrtimit nga ana e GJK-së pas dërgimit të tij nga GP i PDK-së dhe i LDK-së.

Në dy raste të tjera, Kuvendi evitoi disa nga shkeljet kushtetuese të dy ligjeve të propozuara nga ana e Ministrisë së Drejtësisë. Projektligjet për Ndryshimin e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale pësuan ndryshime gjatë punës në grupet punuese në Komisionin për Legjislacion pas rekomandimeve të IKD[27], ndryshime të cilat u reflektuan në ligjet finale që u miratuan nga Kuvendi.[28]

Po ashtu në një rast tjetër, IKD, gjen se Qeveria propozoi ndarjet buxhetore për vitin 2023 së bashku me një nen i cili binte ndesh me Kushtetutën e Kosovës. Në një dispozitë të këtij ligji, qeveria i mernte paratë nga të hyrat vetanake të komunave mjete të cilat komuna të caktuara nuk kishin arritur t'i shpenzonin gjatë vitit fiskal.

Me përplasje ndërmjet pozitës dhe opozitës në Kuvendin e Kosovës, ky i fundit evitoi shkeljet kushtetuese të këtij ligji duke propozuar ndryshimin e asaj dispozite ku Qeveria tanimë përmes ligjit paraprak nuk i kishte transferuar të hyrat vetanake të komunave.

[22] Aktgjykim në rastin nr. KO100/22 dhe KO101/22, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, 5 prill 2023. (Shih linkun [https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/04/ko\\_100\\_101\\_22\\_agj\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/04/ko_100_101_22_agj_shq.pdf)), (Qasur për herë të fundit me 8 janar 2024).

[23] "Projektligji për Pagat në Sektorin Publik", IKD, Dhjetor 2022. (Shih linkun: [https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/IKD\\_Projektligjin-per-Pagat-ne-Sektorin-Publik-1.pdf](https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/IKD_Projektligjin-per-Pagat-ne-Sektorin-Publik-1.pdf)), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2024).

[24] "IKD ka deponuar kërkesën tek Avokati i Popullit që ta procedojë Ligjin për Pagat në Sektorin Publik në Gjykatën Kushtetuese", IKD, Janar 2023. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-ka-deponuar-kerkesen-tek-avokati-i-popullit-qe-ta-procedoje-ligjin-per-pagat-ne-sektorin-publik-ne-gjykatën-kushtetuese/>), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2024).

[25] "Politizimi kundër kushtetues i ANJF" 2022, Instituti i Kosovës për Drejtësi. (Shih linkun <https://kli-ks.org/politizimi-kunder-kushtetues-i-anjff/>), (Qasur për herë të fundit me 8 janar 2024).

[26] "Tendencat për politizim të KPMSHCK", 2022, Instituti i Kosovës për Drejtësi. (Shih linkun [https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/10/Draft-Raporti\\_Tendencat-per-nderhyrje-kunderkushtetuese-ne-KPMSHCK-PDF-1.pdf](https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/10/Draft-Raporti_Tendencat-per-nderhyrje-kunderkushtetuese-ne-KPMSHCK-PDF-1.pdf)), (Qasur për herë të fundit me 8 janar 2024).

[27] "Masat represive për mbrojtjen e grave" 2022, Instituti i Kosovës për Drejtësi. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/11/IKD-Masat-represive-per-mbrojtjen-e-grave.pdf>), (Qasur për herë të fundit me 8 janar 2024).

[28] "Kuvendi adresoi disa nga rekomandimet e IKD-së në miratimin e Projektligjit për Ndryshimin e Kodit Penal dhe të Procedurës, disa nga dispozitat e tjera shihen me mëdyshje" 2023, Instituti i Kosovës për Drejtësi. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/kuvendi-adresoi-disa-nga-rekomandimet-e-ikd-se-ne-miratimin-e-projektligjit-per-ndryshimin-e-kodit-penal-dhe-te-procedures-disa-nga-dispozitat-e-tjera-shihen-me-medyshje/>), (Qasur për herë të fundit me 8 janar 2024).

Këto mjete, të cilat komunat nuk i kanë shpenzuar gjatë vitit 2022 dhe vitet e tjera paraprake ishin bërë pjesë e buxhetit qendror.

Në procedurë të shqyrtimit pranë GJK-së janë edhe gjashtë ligje dhe dy vendime të Kuvendit të Kosovës (Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, Kodi Nr. 08/L-032i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore, Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës Civil, Vendimi i Kuvendit të Kosovës për shkarkimin e anëtares së bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, Ligji për Investimet e Qëndrueshme, Ligji për Fondin Sovran dhe Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e anëtarit të KPK-së).





## Kontakt

Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD  
Adresa: Rruga "Ilaz Agushi", Numër 146.  
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

E-mail: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
web: [www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)